



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01.Nr. 06-1289/17

KLINË, 27.1.2017

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

NGA SEANCA E PARË E KK, TË MBAJTUR, MË 27.1.2017, NË ORËN 10:00, NË
SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, Nënkyetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK (27), drejtorë të drejtorive komunale, komandanti i Policisë në Klinë, Rexhë Berisha, përfaq. të KFOR-it, përfaq. të OSBE-së, Zyra ligjore, Zyra e Auditimit, Nexhat Avdullahu, kryeshef i KRM "Ambienti" në Pejë, OJQ "Koha", Zyra për Informim etj.

Seancën e hapi dhe e udhëhoqi kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i falënderoi pjesëmarrësit për pjesëmarrje në këtë seancë të KK. "Ju uroj punë të mbarë për këtë vit të gjithëve juve këshilltarëve komunal dhe ekzekutivit. Hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Skënder Merturi, tha se fillimisht dëshiroj për t'u ndërlidhur me seancën e kaluar. "Unë kam marrë një letër prej Shërbimit të Kuvendit lidhur me pyetjen, por përgjigjen nuk e kam marrë. Pyetja ka qenë lidhur me vendosjen e fotografisë të "ashtuquajturit President të Republikës, edhe nuk kam marrë përgjigje në pyetje, pra kam marrë vetëm këtë letër, por përgjigje nuk kam marrë. Thjesht, kisha pasur dëshirë për ta marrë një përgjigje mbi cilën rregullore dhe ligj është thirrur Shërbimi i Kuvendit që ka vendosur atë fotografi, e para. E dyta dua të ndërlidhem edhe me disa pyetje ose shqetësime të seancës së kaluar që kam shprehur, po ashtu nuk kam marrë shpjegim, shpresoj të marr një përgjigje ose shpjegim tani, e dyta ka qenë lidhur me një prononcim të nënkryetarit të komunës që e ka pasur dhënë te emisioni kallzo.com ose "Jeta në Kosovë", që është e njëjta. Prononcimi ka qenë kështu: "Më 9 qershor që pat deklaruar nënkryetari i komunës lidhur me varrezat e dëshmorëve që deri në fund të vitit kemi për t'i rregulluar ato varreza, por deri me sot, domethënë ka filluar viti i ri 2017 dhe nuk ka asgjë. Thjesht, vazhdoj dhe bëj pyetjen e njëjtë, a është menduar dhe kur do të rregullohen ato varreza në atë gjendje të mjerueshme që janë. E treta, pata kërkuar shpjegim lidhur me një grup që pat shkuar për të hartuar një Draft-strategjik të zhvillimit ekonomik 2017-2021, ai grup më saktësisht ka qenë i përbërë prej 10 vetëve, me sa di unë në Durrës kanë qenë 21 vetë ose 25. Thjesht nuk e japin atë shpjegim pse aq shumë dhe me cilin buxhet janë shkuar, a kanë marrë mëditje ata që kanë shkuar, kur Kosova dhe Klina i ofrojnë ato mundësi. Unë e di që edhe njerëz që s'kanë të bëjnë kurr gjë me atë

zhvillim të strategjisë së zhvillimit kanë marrë pjesë. As për këtë nuk kam marrë shpjegim, thjesht po kërkoj shpjegim pas ai grup aq i madh. Një shqetësim tjetër që është i ri tash, unë bashkë me Rasimin dhe bacin Pjetër kemi qenë anëtarë të Komitetit për Prona, e kemi ngritur disa herë shqetësimin e pronave të Komunës, por asnjëherë nuk kemi marrë shpjegim. Mbledhjet që i kemi mbajtur në atë komitet ka qenë më 30 prill 2015, për pronat shoqërore të Komunës nuk kemi marrë shpjegim, më 30 qershor për pronat shoqërore të uzurpuara të Komunës nuk kemi marrë shpjegim, edhe e di që edhe si KPF edhe si KK i kemi diskutuar, i kemi përmendur pronat e Komunës së Klinës për të ditur ku i kemi. Thjesht kemi kërkuar një shpjegim ose një listë të pronave të Komunës së Klinës, por deri me sot nuk kemi arritur për ta marrë një listë. Do të kishte qenë shumë me rëndësi për të marrë një listë të pronave të Komunës së Klinës. Ne e dimë që Komuna e Klinës ka edhe lokale afariste, ka edhe banesa, ka edhe tokë, nuk e dimë cila është ajo tokë . ku është, kush e shfrytëzon, a është e uzurpuar apo si qëndron problemi i tyre , por edhe i banesave ashtu , se neve po na vijnë në KPF plot kërkesa të qytetarëve që kërkojnë strehim, mirëpo ne nuk e dimë gjendjen e atyre. Thjesht ajo që kam marrë unë, por edhe ju çka keni marrë është një listë e atyre borxhlinjve të shfrytëzuesve të banesave. Këtu është potencuar se ata kanë qenë me një kontratë, nëse nuk gaboj, dhjetëvjeçare dhe atyre iu ka kaluar afati dhe nuk e dimë qysh ka mbetur. Unë i kam disa informata që një person që ka qenë duke banuar aty, mandej e ka lëshuar me qira që është jashtë rregullores. Thjesht, kryesues kisha kërkuar dhe po kërkoj prej jush që në seancën e ardhshme të na sillat një dokument lidhur me këto pronat. Thjesht, ka pasur mbetur për të na ardhur një dokument më pronat e Komunës, në seancën e kaluar, domethënë deri në fund të vitit, por nuk është ardhur. E di që është pak problematike, por është një çështje shumë e rëndësishme që ne duhet për ta marrë një shpjegim lidhur me pronat e Komunës”, ka konstatuar anëtarë Merturi.

Haxhi Ibishi, tha se çështjet e ngrehura të anëtarit Merturi kanë qenë deklarime jashtë rendit të ditës dhe sigurisht që shërbimet dhe drejtoritë gjegjëse për çështjet që ka ngritur këshilltari është mirë për të dhënë përgjigjen në seancën e tashme, te pyetje dhe përgjigje ose në seancat e radhës.

Ramush Agushi, tha se pata që si pikë e veçantë të rendit të ditës të përfshihet, Diskutim rreth pasqyrave financiare të 2016-2017 të kompanisë “Ambienti” në Pejë. “Në qoftë se ka nevojë për sqarim është edhe ekzekutivi, drejtori gjeneral i kompanisë, gjegjësisht janë edhe personat adekuatë që mund të japin sqarime. Pra, kërkoj që të përfshihet si pikë e rendit të ditës”, shtoi anëtarë Agushi.

Gjokë Lleshaj, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, në mënyrë kronologjike sqaroi çështjen në shqyrtim. “Ndoshta keni të drejtë të thoni nga doli edhe një pikë e rendit të ditës. Sipas asaj agjendës që ju kemi shpjeguar edhe në mbledhjen e jashtëzakonshme, është një kriter që ka qenë Pasqyra financiare të vitit 2014-2015 të jenë të audituara nga Auditorët e pavarur të KRM “Ambienti” në Pejë dhe këto të jenë të diskutuara në KK. Nuk kërkohej miratim, por diskutim. Nëse ndokush ka diskutim rreth këtij materiali që ne dje e kemi pranuar, këtu kemi edhe përfaqësuesin e kompanisë, ndoshta me vështirësi dhe ndoshta me pak vonesën e tyre, por e keni materialin këtu. Unë kërkoj nga ju të kemi mirëkuptim dhe ta diskutojmë, nuk lypet miratim, është kriteri, që edhe ky kriter, realisht që kemi pasur më 31. 12.2016 për të përfunduar, kështu që kërkoj nga ju që të keni mirëkuptim dhe ta diskutojmë, pastaj këto kanë për t’u futur në faqen e Komunës ose në faqen zyrtare të kompanisë dhe ne këtë kriter e plotësojmë dhe i bashkëngjiten atyre kriterëve të tjera dhe më 28 shkurt do të jemi të gatshëm për të vazhduar garën. Kështu që kërkoj mirëkuptim prej jush. Çdo gjë rreth materialit

që kërkohet më shumë është edhe përfaqësuesi gjeneral i kompanisë i cili mund të jap edhe sqarime më të hollësishme”, ka shtuar drejtori Lleshaj.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në shqyrtim. “në vazhden e këtyre përpjekjeve që është duke bërë Komuna për të konkurruar në një projekt të përbashkët që çështjen e menaxhimit të mbeturinave është dashur për të kaluar edhe faza e diskutimit nëpër AK të një raporti financiar të kompanisë “Ambienti”, ku edhe Komuna jonë ka asetet e veta. Unë mendoj që kështu është formulimi, është për diskutim për AK. Ne e dimë që rendin e ditës e formulojmë me kohë, domethënë ky është njoftim, jo diskutim”, sqaroi kryesuesi.

Enver Berisha, nënkryetar i Komunës, në mënyrë kronologjike foli rreth çështjes në shqyrtim. “Në kuadër të kriterëve që ka paraparë GIZ-i gjerman është edhe auditimi i kompanive publike për financat që ata i kanë paraparë për atë periudhë dyvjeçare. Dhe, një prej kriterëve është edhe njoftimi i Asamblesë Komunale me këto financa, gjegjësisht me këtë raport të auditimit. Domethënë, ne nuk kemi nevojë për të nxjerrë kurrfarë vendimi për këtë raport të këtyre financave. Domethënë është kriter nga GIZ-i gjerman, nuk është diçka që në po shpikim ose që ne po duam për t’i ikur cilësdo teme, por e jona është me e thënë ashtu qysh na është kërkuar. AK të njoftohet me Raportin e Auditimit për kompaninë “Ambienti”, ka sqaruar nënkryetari Berisha.

Fadil Gashi, tha se e para, drejtori ishte i paqartë, që e tha për ta miratuar nuk keni nevojë, unë po e sqaroi pak: “Referojeni LVL, çdo raport financiar, çdo njoftim, çdo lëvizje financiare, duhet për të kaluar përmes KPF-së, pikë. Ne nuk jemi të thirrur këtu as çka kërkon ligji as çka rekomandon ligji. Ky Kuvend është i obliguar për ta respektuar Ligjin pikë e presje. Nuk duhet vetëm për të njoftuar, nëse i referoheni qysh po thotë edhe nënkryetari, ka ndodhur shkelje, ne tash nuk mund t’i mbulojmë shkeljet që kanë ndodhur në vazhdimësi dhe që s’ka pasur një raport të Auditorit të Brendshëm, i jashtëmi ka pasur, por nuk na e kanë pasqyruar, i brendshmi nuk e di a na e ka bërë ndonjëherë ndonjë raport, sepse këto ndërmarrje publike, ju e dini menaxhohen prej Komunës dhe kanë pasur obligim për të prurë edhe raportin financiar dhe me ua miratuar ne, prandaj, edhe vjen raportimi, jo vetëm njoftim. Çdo kompani që merr dhe shpenzon buxhet të Kosovës ka obligim edhe me iu nënshtruar auditimit, por edhe raportimit, por edhe ne për t’ju miratuar edhe projektet qysh na i keni prurë. Tash vetëm keni filluar, është kjo lëvizja e re, por nuk do të thotë për ta mbuluar atë që s’ka ndodhur deri sot. Ne sot bëjmë shkelje nëse nuk i hymë një shqyrtimi dhe një miratimi të raportit financiar, të pasqyrave financiare. Dhe cilido prej nesh, ne e kemi pasur edhe në të kaluarën në seancën e jashtëzakonshme që është dashur për ta mbajtur për hir të këtyre afateve. Po kjo nuk e lëndon asgjë, këtë s’mund ta arsyetoni, sepse nëse kanë mbetur të gjitha ato dokumente që na thanë GIZ-i ka kërkuar afate, domethënë që ka mbetur që në seancën e radhës për t’u miratuar të gjitha ato dhe të shkojë edhe ky bashkë me ato edhe na vjen edhe materiali. Unë nuk e di se çka miratojmë, asnjë gjë, asnjë cent përpara nuk e kemi. Unë nuk e di çfarë vjersha na thonë këtu përpara. Ne duhet për ta pasur një dokument, duam të dimë çka ka ndodhur, duam të dimë cilat janë të hyrat, cilat janë të dalat, sa është implementuar buxheti, sa nuk është implementuar, cilat projekte janë investuar në kuptimin e vlerës. Por tash përmendsh ju kërkoni si të doni, por për qëndrimin tonë si LDK e jep shefi i grupit, por unë vetëm desha për të treguar se që kjo absolutisht fare në rregull nuk është, se nuk ka baza ligjore as kurrfarë”, ka konstatuar anëtarë Gashi.

Pal Berisha, tha se ato që i pata për t'i thënë i tha z. Gashi. “Sinqerisht mendoj që është e pakuptimtë të futet një pikë e veçantë të rendit të ditës pa asnjë faqe material, asnjë faqe njoftim dhe asgjë me shkrim, vetëm këtë po e shtoj”, tha anëtari Berisha.

Haxhi Ibishi, tha se Enveri e precizoi thjesht, e korigjoi pak fjalën “diskutim” dhe fjalën “njoftim” i pasqyrave financiare të audituara nga Auditori për kompaninë “Ambienti për vitin 2014-2015, ky është propozimi për pikë të rendit të ditës, shtoi Kryesuesi”.

Qamile Qitaku, tha se unë kam një pyetje për Kryesuesin: “Po më intereson sa vlen ky rend i ditës kur çdo herë para çdo seance kemi nga një promovim politik, domethënë nuk respektohet ajo që është edhe gjithëherë ka pyetje dhe përgjigje, domethënë që ne e kemi edhe një pikë shtesë, një pikë të rendit të ditës e kemi kur i shtohen aty pyetje – përgjigje. E dyta, me çfarë të drejte u lejohet të ashtuqajturit asamblist të Vetëvendosjes për t'i kontestuar organet e Republikës së Kosovës që Presidentin ta thirr “të ashtuqajtur”. Ju lutem, unë për veten time distancohem nga ky qëndrim, mirëpo nuk është në rregull të lejohet ai sa herë i teket bën lojë fëmije me organet të Republikës së Kosovës”, tha anëtarja Qitaku.

Tunë Dedaj, tha se unë e kam një mendim, propozimi që u bë për t'u shtuar kjo pikë e rendit të ditës është mirë të shtohet, por është mirë me sa u informuam materiali ekziston për të na u dhënë dhe është mirë të na lejohet ta diskutojmë rreth materialit. “Do të thotë është mirë të përfshihet si pikë e rendit të ditës, por të na jepet materiali të dimë se çfarë kemi për të folur ne”, tha anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, tha se nëse hyn si pikë e rendit të ditës menjëherë shpërndahet materiali.

Enver Berisha, tha se unë veç po dëshiroj për ta vërtetuar edhe një herë saktësinë e kërkesës që ka ardhur nga GIZ-i gjerman, edhe për atë u konsultova edhe me menaxherin e kompanisë. “Domethënë, kompania “Ambienti” është kompani e përbashkët rajonale dhe nuk është njësi vetëm Klina këtu dhe për hir të asaj që është njësi rajonale nuk ka nevojë për t'u diskutuar ky raport dhe për t'u aprovua nga AK se ka karakter jashtë komunal dhe GIZ-i ka kërkuar strikt një njoftim para asamblistëve për këtë raport. Nëse dëshirojmë për t'iu referuar kësaj dhe për ta fituar grandin në kështu duhet për t'i përfillur kërkesat që na vinë prej tyre, se është shuma fillestare 150 mijë euro, edhe vazhdon më tutje. Nëse duam të bëjmë kalkulime tjera atëherë gjithkush e mban përgjegjësinë për vete, por kryesuesi është i obliguar më e qitë në votim”, ka sqaruar nënkryetari Berisha.

Kryesuesi e futi në miratim propozimin e anëtarit Agushi. Njoftim të pasqyrave financiare të kompanisë “Ambienti” për vitin 2014 – 2015, që është kryer auditimi.

Me 16 vota për, 6 kundër, 2 të përmbajtur miratohet si pikë shtesë e pestë rendi i ditës propozimi i anëtarit Agushi.

Vlora Tafili, tha se e pata edhe unë një propozim për përfshirjen në rend të ditës, është viti i katërt i mandatit që akoma nuk me jeni përgjigjur në pyetjet e mia. “Kështu që unë kërkoj që si pikë shtesë e rendit të ditës të jetë, Informim për mirëmbajtjen e rrugëve nga bora, edhe drejtori Gjokë Lleshi të na përgjigjet”, tha anëtarja Tafili.

Haxhi Ibishi, tha se domethënë është edhe një kërkesë në pikën pyetje dhe përgjigje atje poshtë, Informatën shtesë për gjendjen e rrugëve në Komunën e Klinës.

Tunë Dedaj, tha se kërkesa e Vlorës është që të shqyrtohet sot për hir se kur të shkon dimri kot shqyrtohet. “Anëtarja Tafili ka ngritur si shqetësim jo vetëm në emër të vet, por në emër të grupit parlamentar të AAK-së dhe është mirë të vihet në votim edhe të votohet se është në interes të qytetarëve të Komunës së Klinës, shtoi Dedaj.

Fadil Gashi, tha se nuk po dëshiroj për t’u prononcuar, e thashë edhe më herët, është shefi i grupit që i jep qëndrimet tona. “Unë e kam problemin me ju, Kryesues, na ke ftuar në zyrën e juaj, unë kam zëvendësuar shefin e grupit, sepse me ke ftuar për ta ndërtuar rendin e ditës dhe e di që kam qenë prezent, sikur me tjerët, që është thënë se ekzekutivi nuk ka pasur asnjë kërkesë tjetër dhe tash po i ofrohem orës 11 dhe ju shkoni duke shtuar nga një gjysmë pike, nga një pikë duke shkelë ligj. Unë po e di që keni shqetësime të mëdha, por nuk po dua të besoj kësaj që jeni kaq jo seriozë. Ne i ndërtojmë qëndrimet, ne jemi marrë vesh për rendin e ditës, ju vini na sillni material, a të lexojmë ne tash apo t’ju dëgjojmë juve?!” – tha anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se është e vërtetë që është një praktikë që në çdo para takim ose fill pas KPF-së mbajmë takim me GP nuk ka pasur kërkesa shtesë rreth rendit të ditës as prej ekzekutivit, as prej GP tash që po ngrisin këtë problem për shembull akut, ndërkohë ndodhi një kërkesë për seancën e jashtëzakonshme dhe në vazhden e plotësuam rendin e ditës sot me prapë kërkesën e ekzekutivit, mua më duhet për të proceduar me kërkesën e këshilltares për ta shtuar rendin e ditës edhe një pikë, se për të parën u deklarua si shtesë, kush është që si pikë e 6 e rendit të ditës të shtohet, Informatë mbi gjendjen e rrugëve në Komunën e Klinës, kërkesën e këshilltares Tafili, e mbështeti shefi i GP të AAK-së,

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Me 27 vota për u miratua propozimi që në rend të ditës të futet, Informatë mbi gjendjen e rrugëve në Komunën e Klinës.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës me dy pikat shtesë.

Me 22 për, 5 kundër, pa abstenim u miratua ky rend i ditës me dy pikat shtesë.

REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit vjetor të punës së KKSP për vitin 2017,
4. Pyetje – përgjigje të këshilltarëve
5. Njoftim rreth pasqyrave financiare të kompanisë “Ambienti” për vitin 2014 – 2015,
6. Informatë mbi gjendjen e rrugëve në Komunën e Klinës (ref. Drejtorja SHPE).

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi që nuk pati mungesa nga ana e këshilltarëve.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar.

Fadil Gashi, pati vërejtje rreth procesverbalit të seancës së kaluar, gjegjësisht rreth përshkrimit të diskutimit të tij në procesverbal.

“Tash e kam zëvendësuar denjësisht profesorin Ndue te procesi. Vetëm kisha dashur për ta përmirësuar se unë e kam pasur një vërejtje serioze në seancën e kaluar rreth procesit, ku ka qenë një lëshim ku thuhet: “Fadil Gashi nuk pajtohet me diskutimin e tij”. Ishte absurd i llojit të vet., qysh mund të kem vërejtje në diskutimin tim?! Tash problemi është edhe më i madh se tash thotë: “Nuk pati vërejtje hiq askush prej anëtarëve të Kuvendit. E qiti kryesuesi në shqyrtim edhe nuk pati vërejtje dhe u miratua unanimisht”. Të paktën potenconi se ka pasur një vërejtje edhe le të kalojë jo krejt thjeshtë veç ashtu”, tha anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se gjithmonë në votim e kam qitur gjithherë me vërejtje. “Ndoshta këtu nuk është korrigjuar, por edhe procesverbalin e seancës së kaluar kur është miratuar unë e kam qitur në miratim me vërejtjet e këshilltarëve”, sqaroi Kryesuesi.

Nuk pati debate tjera. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin me vërejtjen e këshilltarit Gashi.

Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit vjetor të punës së KKSBB për vitin 2017.

Enver Berisha, raportoi në mënyrë kronologjike rreth Draft-planit vjetor të punës së KKSBB për vitin 2017. “ Besoj që edhe KPF edhe ju si anëtarë të AK jeni pajisur me materialin që është paraparë në kuadër të këtij plani komunal për Sigurinë në Bashkësi, plan i cili është i bazuar në Strategjinë Nacionale, edhe unë duke u bazuar në vlerësimet që ne i kemi pasur si KKSBB gjatë krejt kësaj periudhe trevjeçare sa kemi funksionuar bashkë, jemi të vetëdijshëm se jo të gjitha planifikimet që i kemi pasur edhe në kuadër të planit të kaluar kanë mbërrirë për t’u realizuar, duke pasur parasysh që ka pasur edhe mungesë buxheti që ai plan të realizohet krejtësisht dhe kemi paraparë se ky plan për këtë vit të jetë i ndërtuar prej 9 pikave në kuadër të cilave janë prezantuar edhe janë paraparë segmente të caktuara të problemeve të caktuara dhe ne si Këshill Komunal për Siguri në Bashkësi jemi munduar që të ofrojmë një mundësi që ju ta vlerësoni dhe duke u bazuar në kohën që e keni edhe sot në dispozicion që rendi i ditës nuk është i ngarkuar me shumë pika, kisha kërkuar që secili nga ju si asamblistë për ta dhënë kontributin e juaj në kuadër të këtij plani, i cili është domosdoshmëri për çështjen e sigurisë në komunë, edhe duke u bazuar në atë të drejtës se ky plan sado që është draft e ka mundësinë që ju ta ndryshoni, të shtoni, të plotësoni, i vetëdijshëm se mund të ketë edhe gjera që ne nuk kemi mundur për t’i paraparë, por ato 9 pika që ne i kemi paraparë për t’i prezantuar në kuadër të këtij plani e kemi vlerësuar se janë pikat më të domosdoshme dhe që llogarisim për të caktuar nga drejtoritë përkatëse dhe nga qeverisja komunale për ta implementuar gjatë kësaj periudhe trevjeçare. I vetëdijshëm se në KPF janë ngritur dy-tri shqetësime, të cilat unë i kam marrë edhe nga kryesuesi. E para se është plan i ndërtuar mbi strategjinë 2011-2016. Ne ende nuk kemi marrë strategji të re nga niveli nacional dhe ne kur pajisemi me strategji të re edhe ne jemi të obliguar për t’i përshtatur me atë strategji, por

përderisa është kjo në fuqi dhe aktuale jemi detyruara që ta përfillim këtë strategji nacionale. E dyta se ka shumëçka që është edhe një bartje e planifikimit që është i digjitalizuar që është evidente për faktin se çështja e sigurisë është çështje vazhdimësie me sfidat dhe problemet, edhe për faktin tjetër jo gjithçka ka mbërrirë për t'u realizuar, edhe si rezultat i mungesës buxhetore që të realizohet ky plan krejt në tërësi. Mendoj që ju e keni sot mundësinë që vërtet të jepni kontributin tuaj në kuadër të këtyre 9 pikave ose nëse mendoni të shtojmë diçka nëse mungon diçka krejtësisht në këtë plan të veprimit”, ka shtuar nënkryetari Berisha.

Kryesuesi hapi diskutimi.

Vlora Tafili, tha unë e kam analizuar pak a shumë planin vjetor të punës së këshillit prej themelimit, mars 2014 dhe 2017, edhe ky plan i punës, si për nënkryetarin ashtu edhe për mua është goxha qesharak, nuk ka asnjë dallim të objektivave prej 2014 e deri me tash. “Krejt gjerat çfarëdo përshkrimi të iniciativës, krejt të njëjta Dhe nëse ne jemi duke i dhënë shuma 40 mijë euro, përkatësisht jemi duke bërë kërkesa buxhetore për të njëjta objektiva, domethënë për të njëjtën infrastrukturë, jemi dukë ndarë buxhet që katër vjet rend. Edhe e çuditshme është që si institucionet e ndryshme dhe fushatat vetëdijesuese të organizmit, kampanja që shkojnë 300-1500 euro, që përsëriten çdo vit, këtu në letër i shoh, por asnjëherë nuk kam pasur rastin për t'i hasur në Komunën e Klinës duke u zhvilluar. Unë, përpos kësaj kisha pasur edhe nja tri pyetje për nënkryetarin, edhe desha ta pyes, a ekziston një grup i cili merret me funksionalizimin e këtyre objektivave që janë të parashtruara në plan vjetor të punës, nëse nuk është do të kishte qenë mirë të formohet nga Komuna. Pse nuk kemi asnjëherë një raport të Komunës tonë për të na treguar se si shkojnë procedurat dhe plani e punës, edhe si është gjendja e rasteve kriminale në Komunën e Klinës ose raportim se si janë realizuar objektivat dhe buxhetimi, sepse goxha do shuma ishin këtu, nënkryetar”, ka konstatuar anëtarja Tafili.

Skënder Merturi, tha se në atë që e tha kolegja pak më parë, unë vazhdoj për ta mbajtur si subjekt qëndrimin. “Për mua kjo fotografi është e jashtëligjshme, për mua ai është i ashtuquajtur President, për mua nuk përfaqëson interesin të Republikës së Kosovës. E dimë mënyrën qysh është zgjedhur Parlamenti i Republikës i rrethuar me ushtri, me polici me tanke, sikur të ishte luftë, prandaj nuk përfaqëson interes. Po dua të ndërlihem me atë që e tha nënkryetari i komunës: që ka shumë ngjashmëri me raportet e kaluara me këtë që na ka ardhur, dallimi është se në këtë ia paskan ndërruar datën 2017, në KPF ka qenë 2016, thjeshtë, nënkryetar do të kishte qenë mirë ne ta kemi edhe një raport tjetër mbi punën çka është arritur, çka është bërë me punën e kaluar. Thjesht, po paraqitet për këtë vit çka po mendohet për t'u punuar për këtë vit 2017, por nuk na paraqitet një dokument çka është bërë më 2016 dhe vëshië3sitë aty. Thjesht do të kishte qenë mirë për ta pasur një raport në bashkëpunim edhe me Komandantin e Policisë, për ta pasur një raport mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Klinës, në bashkëpunim me policinë. Ne e dimë që Komuna e Klinës në vitin e kaluar është ballafaquar me disa, kryesisht po them, disa vjedhje të lehta, shlyqyr që nuk ka pasur raste të rënda, por do të kishte qenë mirë ta kemi një raport me në detale, nuk po dua te hedh tërësisht poshtë këtë”, ka pohuar natari Merturi.

Haxhi Ibishi, sqaroi rreth vendosjes së presidentit Thaçi në sallën e Kuvendit të Komunës. “E kemi ruajtur nivelin e komunikimit mes vete, qëndrimet individuale të secilit dhe të subjekteve politike, prandaj ta ruajmë komunikimin mes vete dhe të mos ofendojmë strukturën maksimale të organizimit shtetëror të shtetit tonë për qëndrime të ulëta politike. Ne jemi këshilltarë, jemi të zgjedhur të popullit, Presidenti Thaçi është president i Republikës së Kosovës, është përfaqësues i unitetit të popullit, pavarësisht që dikush në momente të caktuara mund të ketë mendime të tjera. Prandaj, ju kisha lutur që në këtë frymë, sikurse që kemi pasur dilemat rreth presidentëve të kaluar, Kosova ka për t’i pasur edhe dilemat e veta, por fjalorin e fyerjes në adresë të institucionit më madhor të RK nuk guxon për të ndodhur në këtë Kuvend dhe njerëzit duhet të distancohen prej këtij fjalori. Ju kisha lutur për mirëkuptim dhe për të mos qenë në këtë vijë të komunikimit”, shtoi kryesuesi Ibishi.

Sokol Bashota, tha se unë prita për këtë Plan Komunal për Sigurinë e Bashkësive për të reaguar nënkryetari, i cili e ka të drejtën, por tamam po plotësohet ajo maksima që thuhet në popull që “nipi qet pushkë për dajën”, besoj që e kreu edhe do ta ketë parasysh këtë. “Ky është një projekt që nuk është zbatuar më 2007, edhe 2016, edhe 2015, që pritet për t’u implementuar tani. Sa i përket vendosjes së fotografisë së Presidentit Thaçi në sallën e KK, kam menduar se do të kishte qenë e nevojshme për ta pyetur vetëm Bozhidarin”, theksoi kryetari Bashota.

Arben Limani, kërkoi sqarime rreth Planit të Veprimit të KKSP. “Unë desha një sqarim këtu te Plani i Veprimit, që sipas kësaj renditje që është bërë me numër të pika 4, domethënë ne mendojmë që duhet t’i shtohet atyre institucioneve përgjegjëse, duhet t’i shtohet edhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Veterinës si sektor. Mund të marrim ndoshta edhe sqarime shtesë nga nënkryetari, i cili referoi i pari lidhur me këtë temë . Gjithashtu, këtu është evidentuar problemi i gropës që e ka hapur ndërmarrja e Boksive, ai problem ka ekzistuar edhe më herët, ndoshta ndonjë opinion është menduar për të vepruar aty, edhe një sqarim ose rimodifikim i këtij teksti se unë nuk e kuptova, besoj që nga ekzekutivi mund të na sqarojnë, te pika 8: “Vetëdijesimi dhe ndryshim të rregullores në respektim të definimit të qartë të cilit komunitet si i veçantë RAE, në përputhje me ligjin dhe rregulloren në fuqi”. Këtu duhet një rimodifikim këtij teksti, sepse nuk po u merrte vesh çka është dashur të thuhet. Përndryshe ne si grup i LDK-së e mbështesim si Plan të Veprimit”, ka konstatuar anëtari Limani.

Enver Berisha, edhe një herë sqaroi PVKSP për vitin 2017. “E para, me respektin maksimal për kontributin e gjithsecilit që mundohet ta jep në cilindo material, jo vetëm në këtë, por unë detyrimisht po e ndjej për obligim për ta thënë para jush, mund ta marr kush si të dëshirojë. Nganjëherë po krijohet përshtypja që gjithçka çka po ofrohet këtu po ofrohet për të kritikuar, nuk po ofrohet më ju dhënë orientim, me dhënë mendim, me dhënë propozime konkrete, të cilat po e ndihmojnë situatën, e ndihmojnë planin, e ndihmojnë problemin për zgjidhje, por në veçanti dua t’i drejtohem asamblistit të Lëvizjes Vetëvendosje më të cilin unë as sot, as asnjëherë në asnjë pyetje që parashtrohen nga ai unë e ndjej vetën të obliguar asnjë trohë për t’u përgjigjur derisa ai kundërshton institucionin më të lartë të shtetit, Presidentin e Kosovës. Kështu që të mos mundohet të bëjë pyetjen në atë drejtim dhe do të kishte qenë mirë edhe ekzekutivi kështu të veprojë

në raport me te. Sepse, realisht, në mënyrën, në qasjen se si po insistohet për t'u prezantuar situata këtu, nuk meriton sqarim. Po kthehem te kërkesat dhe përgjigjet që po dua t'i jap para asamblistes së AAK-së, Vlora Tafilit. Realisht ka projekte të bartura, e thashë në fillim, ai 40 mijë eurosh është paraparë te ndriçimi i rrugës kryesore, nga magjistratja Pejë – Prishtinë, konkretisht nga Ura e Drinit të Bardhë deri në hyrje të qytetit, që domethënë e kemi vlerësuar se është rruga më e domosdoshme për t'u ndriçuar, dhe kemi qenë në negociata në kohën kur e kemi hartuar projektin me një organizatë të huaj, por ai po thotë ai projekt ka dështuar për të cilat edhe DSHPE është në ngjarje, edhe kemi qenë bashkë në atë projekt, për shkak që qeveria suedeze që është paraparë në atë kohë nuk i ka siguruar ato mjete dhe projekti ka mbetur për t'u bartur në këtë vit dhe ne kemi projekte bashkë edhe me Kryetarin se si ta realizojmë ndriçimin publik në atë zonë, por i vetëdijshëm se grupi komunal për SB i ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore bazuar edhe në ligjin administrativ, në radhë të parë duke i pasur parasysh edhe takimet e rregullta që ka mbajtur, që edhe është obligues, e dyta, në kuadër të atyre takimeve janë trajtuar çështjet e sigurisë për të cilat jo vetëm që janë këtu, por janë trajtuar çështjet edhe siguria në përgjithësi dhe unë kujtoj se nuk ka nevojë më shumë sqarime për t'u dhënë nga askush për faktin se Komuna e Klinës është një prej komunave me sigurinë më të madhe të komunave në Kosovë, që absolutisht nuk ka raste të natyrave të rënda, ka pasur raste minimale të hajnive, por falë kontributit dhe angazhimit të policisë të Kosovës në Klinë, edhe ato janë zvogëluar dukshëm me vetë faktin që janë zbuluar edhe këta keqbërës të këtyre veprave, por fatbardhësisht ato nuk kanë pasur as motiv politik, as nacional, as rajonal. Prandaj falë angazhimit të policisë gjendja është stabile, rastet në pjesën më të madhe janë zbuluar, dhe unë kujtoj dhe ndjej për obligim që ndoshta ne duhet për të paraparë më vonë në cilëndo seancë që ju e vlerësoni për ta dhënë një raportim të krejt situatës së sigurisë në Komunën e Klinës para kësaj AK. Këtë e marr si obligim kur ju e vlerësoni që ne duhet të dalim me një raport konkret se cila është gjendja e sigurisë dhe për temat veç e veç”, ka konstatuar nënkryetari Berisha.

Vlora Tafili, tha se po zoti nënkryetar respekt për policinë e Kosovës, por ato që po i thoni më konkretisht do të kishin qenë mirë që të vihen në letër, jo të na jepen çdo ditë fjalë dhe premtime. “Mirëpo e kam edhe një fjalë për Kryetarin, ndoshta “nipi ka qitë pushkë për dajën”, por unë qes pushkë për krejt. Ju lutem që asnjëherë sa të jem unë në mandat të merrni guximin të më krahasoni ose të më kategorizoni me dikë tjetër”, tha anëtarja Tafili.

Sokol Bashota: “Vlorë, mos e merr shumë afër zemre dhe pa emocione se je asambleiste, përfaqëson një subjekt politik shumë të respektuar, edhe mos e kthe armën prej vetes, sepse nuk ishte për ty, edhe emri nuk t'u përmend, kështu që të kesh kujdes”, u shpreh Kryetari.

Tunë Dedaj, tha se flas në emër të grupit të asambleistëve, Planin Vjetor të Punë për KKSBB është një plan shumë i mirë, që unë për vete e përkrahi, por e përkrahi edhe kolegët e mi, por është mirë që të angazhohemi që ta implementojmë këtë plan pikë për pikë në mënyrë që ta realizojmë”, tha anëtari Dedaj.

Skënder Merturi, tha se në lidhje me atë që e tha nënkryetari Berisha, sa për mua kur të mos më jep përgjigje, nuk e kam atë problem, nuk mërzitem fare. “Më 9 qershor të vitit të kaluar ka deklaruar, është deklarim publik, ky përfaqëson publik, për fjalën publike le të jep përgjegjësi, jo për mua. Për mua nuk ka problem fare, por për fjalët publike duhet për t’i dhënë përgjegjësi një herë. Duhet për t’u mësuar, atë që atë e deklaroi në mënyrë publike, ta jap, se për mua nuk ka kurrfarë problemi, kur të mos më jap përgjigje se nuk e marr afër zemre atë çështje. Por, duhet për t’u lidhur te fjala publike si nënkryetar i Komunës që je deklaruar publikisht, që e ke thënë atë që e ke thënë. Për atë duhet për të dhënë përgjegjësi, për fjalën publike, jo për mua”, ka pohuar anëtari Merturi.

Ndue Shabanaj, tha se unë më se pari dëshiroj për ta thënë një mendim timin për atmosferën e pakëndshme të krijuar në këtë seancë të asamblesë dhe unë mendoj që është e paarsyeshme për të krijuar kësi lloj atmosfere, se nuk i kontribuon as AK dhe aq më pak mirëvajtjes së punëve dhe detyrave që i kemi në si AK këtu. “Ka vende dhe mundësi të shprehen kundërshtimet e subjekteve politike dhe në për të qenë subjekte politike me të njëjtin mendim dhe përkrahje e qëndrime, nuk kishim për të qenë të subjekteve të ndryshme politike, janë të mirëkuptueshme këto, por jo të shfrytëzohen në çdo seancë dhe të krijohet një atmosferë e pakëndshme që të mos e ndiejmë veten mirë të zhvillojmë punimet në seancë në këtë lloj atmosfere. Unë them përgjithësisht, në radhë të parë për ata që iniciojnë proceset të cilat shkojnë në drejtim të një atmosfere të pakëndshme në asamble, Rreth Draft-planit komunal të KKSB, unë mendoj se është një plan shumë ambicioz, përfshin shumë çështje të cilat i kontribuojnë jo vetëm krijimit të sigurisë dhe ngritjes në nivel më të mirë, por i kontribuojnë edhe mirëqenies të përgjithshme të qytetarëve, për shkak se këtu përfshin shumë iniciativa për realizimin e shumë projekteve të ndryshme të cilat janë me të vërtetë nevojat reale dhe të përgjithshme të qytetarëve në nivel të komunës së Klinës dhe të lokaliteteve të veçanta ku banojnë qytetarët. Prandaj, çështje tjetër është sa mund të realizohen këto dhe sa kjo është në përputhje me projektet me prioritet që janë aprovuar në AK. Ishte dashur për të qenë në përputhshmëri më këto, jo vetëm fontanë dëshirash, por të bazuara në mundësitë reale. Këto janë nevojat të gjitha, nuk i kontestoj absolutisht dhe kishte për të qenë shumë mirë nëse këto mund të realizohen. Unë po shoh këtu shumë projekte për të cilat është thënë shumë në asamble, por që nuk kanë arritur të realizohen asnjëherë. Uroj që kjo të ndodh dhe ky draft-plan vjetor i punës së këshillit të realizohet kështu, edhe e ngritë sigurinë e bashkësive në nivel më të larta, por edhe e përmirëson mirëqenien e qytetarëve përgjithësisht. Meqë e mora fjalën për këtë, dua të them edhe diçka, se plani dhe aprovimi i planit nënkupton edhe nevojën për raportim, gjithmonë për të qenë raporti sa kemi mbërrirë për ta realizuar këtë plan dhe çka ka mbetur nga plani paraprak pa u realizuar dhe të përfshihet në planin e ardhshëm. Kështu na krijohet një pasqyrë më reale e asaj që kemi realizuar dhe e asaj që duhet për t’u angazhuar për realizim. Përndryshe është më të vërtetë gjithëpërfshirës dhe meriton për t’u përkrahur”, ka konstatuar prof. Shabanaj.

Kryesuesi vuri në miratim Draft-planin vjetor të punës së KKSP për vitin 2017.

Me 26 vota për, 1 abstenim u miratua Draft-planin vjetor i KKSP për vitin 2017.

Pika e katërt: Pyetje-përgjigje.

Haxhi Ibishi, foli rreth kësaj pike të rendit të ditës. “Unë mendoj që është ekzagjeruar ose ekzauruar tërësisht këto pyetje-përgjigje, thjesht, nëse vetëm dikush ka qysh jemi marrë vesh. Nëse ka ndokush për pyetje, kemi një skemë për pyetje”, tha Kryesuesi.

Skënder Merturi, tha se e kam një sqarim: “Dua ta falënderoj drejtorin e Urbanizmit, z. Baki Gashi, për pyetjen dhe shpjegimin që kemi bërë në fund të seancës së kaluar. Kemi shkuar te vendi i ngjarjes edhe e kemi parë atë që e kam thënë unë, thjesht, informatën që e kam pasur unë ka qenë pak më e hershme, ndërsa kur kemi shkuar me drejtorin e kemi parë se gjendja ishte ndryshuar ose ishte përmirësuar për të mirë, edhe jemi sqaruar me DU me këtë rast, drejtorit faleminderit për atë shpjegim dhe për atë sqarim që kemi qenë atë ditë bashkë”, tha anëtari Merturi.

Enver Berisha, tha se kjo që u tha këtu për mua flet për një situatë që asamblistë të caktuar marrin informata nga rrugët, nga lokalet, të pakonfirmuara si dihet dhe pastaj bien në këso pozita që vërtetë nuk ia vlen as për të bërë pyetje në kuadër të AK. ato që i tha asamblisti këtu janë fjalë të marra nga rrugët”, theksoi nënkryetari

Lorenc Marleku, tha se unë kam bërë pyetje edhe herëve tjera, por nuk me është dhënë përgjigje. “Tabelat orientuese që mungojnë në qytetin e Klinës, vetë jeni dëshmitarë kur vini prej qyteteve tjera dhe duhet gjithmonë të ndalen dhe të pyesin qytetarët se nga është rruga për Skënderaj, nga është për Istog, asnjë tabelë orientuese që mungon as për buxhet, por për neglizhencë, nuk e di arsyen. Kjo është dashur të jepet përgjigje ose në seancën e ardhshme ne do të bëjmë një veprim tjetër”, tha anëtari Marleku.

Kolë Prenaj, drejtor i Inspektoratit, sqaroi anëtarët rreth pengesave në rrugët e Komunës së Klinës. “Me të vërtetë nganjëherë po biem edhe në situata të palakmueshme, më vjen keq se ka pasur edhe pyetje edhe në seancën e kaluar rreth pengesave dhe shenjave të komunikacionit. Sa i përket pengesave, përsëritës edhe komandantin e policisë, është dëshmitar, edhe është përcjellës i mirë në çdo aksion, edhe me regjionin e Pejës jemi konsultuar për shumë çështje. Në çdo pengesë dhe shenjë të komunikacionit kemi vendosur në bashkëpunim me sektorin e shërbimit policor të Klinës. Sa i përket pengesës tek Semira që është e ka pëlqimin prej Ministrisë së Infrastrukturës, bile shkova dhe e mora fizikisht ta prezantoj prej drejtorisë në krye me Mustafë Krasniqin, i cili ma dha një premtim që me mirëkuptim do të investojë t’i zvogëlojë. Vitin e kaluar nuk kemi pasur buxhet për shenjat e komunikacionit, edhe pengesat që janë në rrugë kanë pasur afat dyvjeçar. Ka kaluar afati, mirëpo fatbardhësisht ka qenë edhe kompania serioze, qëndrueshmëria e tyre ka qenë më e gjatë 2014-2015, kështu që është zvogëluar fatkeqësia në komunikacion për 50 për qind. E di që është dëmtuar buxheti i Komunës së Klinës për shkak të gjobave, por është zvogëluar shpejtësia dhe rrezikshmëria e qytetarëve ka qenë më e vogël. Nuk jemi duke pasur mundësi për t’i përmbushur kërkesat e gjithë qytetarëve, sidomos të qytetarëve të komunave tjera përreth, por megjithatë do të shohim që ta zgjedhim edhe këtë problem”, ka konstatuar drejtori Prenaj.

Lorenc Marleku, tha se policia nuk është kompetente për të përcaktuar vendin se ku të vendoset pengesat, janë inspektorët, njerëzit të profesionalizuar.

Tunë Dedaj, tha se ka qenë kërkesë imja kjo edhe e grupit të AAK-së problemi i pengesave në rrugë. “Unë kisha për ta pasur një kërkesë, sot prej Kolës me shpenzime të mia për ta marrë Kolën në veturë timen dhe çdo përfaqësues të grupeve parlamentare për ta pasur dhe të shkojmë deri në Pejë te spitali, dhe nëse është në qytetin e Pejës një pengesë në rrugë prej hyrjes së Pejës deri në spital në rrugë unë do të thotë jam fajtori ai që marr. Por të qiten këto pengesa ku të sëmurit tanë shkojnë përditë andej, kjo është e patolerueshme. Zvogëlimin e shpejtësisë e bën shenja e komunikacionit, policia janë për ta zbatuar me radar, jo pengesa. Kjo është keqpërdorim e inspektorit që ka vënë pengesa në rrugë, kur të sëmurit tanë kanë probleme për çdo ditë. Edhe kisha kërkuar ato pengesë për t’u hequr, edhe nuk e bëj këtë për përfitime politike, por e bëj për hir të të sëmurëve që shkojnë në spital”, ka theksuar anëtari Dedaj.

Kolë Prenaj, tha se po më duket se isha i qartë. “Më 2014 dhe 2015 ka pasur buxhet, janë vendosur më 2014, kryesisht shenjat e komunikacionit. Ju ka skaduar afati i qëndrueshmërisë. Nuk jam unë kompetent për t’i hequr, edhe çdo pengesë që është vendosur është vendosur me kërkesë të qytetarëve, në bashkëpunim me shërbimin policor të Klinës. Për profesionalizëm ndoshta ka ndonjë lëshim. Për vetëdijesim ne e dimë e di që jemi të vetëdijësuar, por fatbardhësisht vitin e kaluar është aprovuar ligji mbi trafikim dhe komunikacion, janë gjobat struktë, janë më të larta, tash mund të flasim me një gjuhë tjetër”, tha drejtori Prenaj.

Arben Limani, tha se pyetjen e parë veç e kemi adresuar te DF para dy seancave, edhe drejtori ma konfirmoi se mundet për t’u përgjigjur dhe lidhet me gjetjen e një mundësie të lirimit nga taksat komunale, ose përgjysmimi i këtyre taksave të lokaleve që preken nga ndërtimi i sheshit. Drejtori ma konfirmoi se mund të përgjigjet. Edhe pyetja e dytë lidhet lidhur me vendosjen e tabelave në rrugë, edhe në fshatra. Këtë përgjigje mund ta marrim edhe në seancën e ardhshme nëse mundet ndokush nga ekzekutivi me përgatitur përgjigjen. Dihet se e vetmja komunë në Kosovë që këtë problem nuk e kemi zgjedhur. Vendosja e tabelave, emërtimi dhe ai sistemi, veç janë kryer dhe kanë kaluar edhe në Kuvend”, theksoi anëtari Limani.

Filloreta Berisha, tha se unë dua për ta ngritur një shqetësim që kam njohur që në shkollën e mesme në Klinë po përdoren substanca narkotike, edhe duhet të ngrisim të gjithë si shqetësim. “Dua informim prej organeve kompetente në seancën e ardhshme që është duke u marrë masa ndaj këtyre keqpërdoruesve se është duke u përdorur shumë, edhe unë tash me fakte nuk mund ta qes, sepse duhet për ta argumentuar atë, por sipas bisedave me nxënës që kam bërë, domethënë është e vërtetë që është duke u përdorur me sasi të madhe, edhe është shqetësim për të gjithë neve, edhe mendoj se duhet ndërmarrë masa për parandalimin e tyre, pasi që është gjenerata më e bujshme për ne, sepse duhet ruajtur atë gjeneratë të mos na kalojë në substanca narkotike qysh se tash”, ka konstatuar Dr. Berisha.

Ndue Shabanaj, tha se do të kishte qenë mirë për ta precizuar pyetjen e Filloretës. “Ne nuk kemi një shkollë të mesme, por i kemi dy, dhe është mirë për t’u deklaruar se cila

është shkollë të mesme. apo janë të dyja. Ky është problem shumë i ndjeshëm, prandaj duhet të përcaktohet qartë, përkatësisht të determinohet”, tha prof. Shabanaj.

Halil Desku, tha se dua t’i bashkëngjitëm diskutimit të profesorit Ndue, por edhe për të shtuar diçka tjetër. “Nëse kjo ka informacione të sakta për ta paraqitur këtu, policisë, drejtorisë së shkollës, Drejtorisë së Arsimit, se vërtetë kjo është e rëndë. Mua po më vjen keq këtë që po e dëgjoj këtu dhe nuk e besoj dhe asnjëherë nuk mund ta besoj, përveç rasteve të izoluar. Unë do të bindem pasi të kryhen procedurat adekuate me ligj. Po them nuk dëshiroj për ta besuar që një gjë e tillë është e vërtetë. Unë aty punoj, di për rastet e izoluar, të pirjes së duhanit te disa vajzave që i ka zënë drejtori i shkollës dhe i ka marrë hapat ligjor”, tha prof. Desku.

Haxhi Ibishi, tha se me sa kam kuptuar doktoreshën e ngriti si shqetësim, në seancën e radhës organet për të debatuar këtë çështje.”Kjo nuk e precizoj, qysh e tha edhe profesori Ndue, për cilën shkollë bëhet fjalë. Këtë e precizon në kërkesën me shkrim që na drejtohet neve dhe ne do të përgatisim një informatë me pikë të veçantë të rendit të ditës. Në qoftë se ky problem është i përmasave të tilla, që ekzekutivi e vlerëson duhet për të dhënë një përgjigje prej kësaj asambleje, ju e dini qëndrimin e organeve. Domethënë secili organ e ka të precizuar detyrat dhe përgjegjësitë që ka karshi ligjit, ato arsimore, edukative, ndëshkuese etj. Unë besoj që doktoresha nuk pat qëllim atakimin e njëres ose tjetër shkollë, por e ngehu si dukuri në qytetin tonë”, tha kryesuesi Ibishi.

Fadil Gashi, tha se edhe është hera e fundit që i kërkoj Halil Desku në emër të PDK-së që përfaqëson, mos të bëhet kujdestar i doktoreshës as i yni. “As nuk mundet me iu përgjigje doktoreshës, as nuk ishte pyetja për të, pyetja ka të bëjë për drejtorin e Arsimit ose për Komandantin e Policisë. Ju merreni vesh kush e bien njoftimin për seancën e radhës, sepse flitet, aty ku flitet, ne nuk jemi organ që verifikojmë, por nëse ka diçka bile sjellkeni informacionin, nëse s’ka, po kujtohen që në vjen keq nëse s’ka, ne gëzohemi po që se nuk ka. Po nëse flitet që ka, këtë informacion e ka policia. Unë kam dëgjuar se e kanë marrë një vajzë. Nëse s’është e vërtetë ne i gëzohemi. Nëse është e vërtetë ejani ta gjejmë zgjidhjen, edhe s’ka nevojë për të ndërhyrë. Për seancën e radhës të na jepet informata. Por të mos jetë kujdestar profesori që i di të gjitha”, ka theksuar anëtari Gashi.

Halil Desku, tha se unë nuk fola në emër të PDK-së as të shefit, fola në dashi si qytetar, si prind, mësues. “Nuk dua të besoj për një gjë të tillë, e në qoftë është e vërtetë jam bashkë për ta luftuar deri në skaj me ligj. Nuk po dëshiroj për t’ju përziej asaj, ajo ka folur, është e drejtë e saj as nuk iu kam përzier në grup të saj, le të flitet gjithnjë e me fakte e të mos biem viktimë sikur Skënderi sot. Thjesht, me fakte dhe bashkërisht t’i luftojmë dukuritë. Edhe një herë përfundimisht: kam folur në dashi si mësues, si prind, si qytetar, jo si PDK, jo si shef”, tha prof. Desku.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në debat. Kryesuesi kërkoj që të mbyllet ky debat. “Qëllimi nuk ishte i askujt aq më pak i doktoreshës as i profesorëve kush të bëhet mbrojtës e kush atakues”, tha Kryesuesi.

Rasim Millaku, foli rreth çështjes në debat. “Vërejtja ime është kryesisht në këtë pikë rreth procedimit edhe të pyetjeve, nëse gjithmonë me të drejtë edhe nëse është e ligjshme me përpiluar edhe pyetje edhe përgjigje, por edhe tema për të ngritur, por vërejtja ime është te organizimi i këtyre pyetjeve. Nëse kërkohet për t’u diskutuar një problematikë, të mos futemi menjëherë në diskutim të asaj pike. Pasi që u lëshuan të gjithë edhe unë dua të lëshohem rreth asaj çështje çka unë di, sidomos për temën që është shumë e ndjeshme dhe shumë e drejtë, edhe një alarm i rremë është i shëndetshëm për fëmijët tanë, edhe sikur të mos jetë e vërtetë. Ne absolutisht asnjë nuk jemi të thirrur për këtë punë për të diskutuar, sikur u tha, ka gjera edhe të vërteta, por nëse mobilizohemi të gjithë është e nevojshme për t’i luftuar, sepse ky fenomen e preokupon gjithë Kosovën. Ndoshta ne si Kosovë jemi më mirë se sa rajonet tjera, kanë depërtuar gjera shumë të rrezikshme edhe nëpër fëmijët tanë. Unë kisha dashur të them që s’ka asnjë, por “alarmi i rremë” i daktoreshës është i shëndetshëm për arsimin në Klinë, shtoi prof. Millaku.

Tunë Dedaj, tha se për ta thënë të drejtën që shqetësimi që ngriti daktoresha është shqetësim për të gjithë ne. “Edhe unë e falënderoj që e ka ngritur dhe është mirë që t’i shkohet asaj çështje deri në skaj të mos ndodh diçka e keqe të fëmijët tanë në shkollat e mesme, por mund të depërtojë edhe në shkollat fillore. Është mirë të ngritet dhe të alarmohet edhe policia, edhe DKA, edhe drejtorët e shkollave, edhe arsimtarët dhe të këqyrim të mos bëhet diçka e keqe, që dikur është e vonshme ajo”, tha anëtari Dedaj.

Filloreta Berisha, tha se nëse dikush më ka keqkuptuar për pyetjen, mua më vjen keq që s’ka mundur të më kuptoj drejt. “A ka apo nuk ka raste, kjo është një gjë shumë e thjeshtë që mund ta diskutojmë dhe ta vërtetuar nëse është e nevojshme. Të shkojmë dhe t’i mbyllim një orë nxënësit komplet dhe t’ju marrim analizat, nëse nuk dalin mbi 30 për qind atëherë do të diskutojmë. Unë po them se është shqetësuese, nuk dua të jem unë ajo që t’i mbrojë, sepse nuk kam kompetencë për t’i mbrojtur ata, por janë organet kompetente. Unë po them për licencën që kam dhe e thirrur për titullin që e kam, çdo muaj ka raste të reja që mua më vinë për t’i trajtuar, çdo muaj lajmërohen raste të reja, besa edhe të shkollës fillore, lëre më të mesmes. Ju si të doni, merreni si të doni, unë po kërkoj një informatë, nuk dëshiroj ta atakoj askënd, sepse e ka përgjegjësi organet gjegjëse, por ne e kemi përgjegjësi të gjithë si qytetarë”, theksoi daktoresha Berisha.

Sokol Bashota, tha se unë posa fola me drejtorin e shkollës, njëerës prej shkollave të mesme dhe s’është e vërtetë ajo përpos që konsumojnë duhan. “E kanë një kontroll brenda mundësive që ju lejon edhe etika e personale edhe ajo ligjore dhe nuk mund t’i kontrollojnë në tualete kur të shkojnë, te shportat vazhdimisht disa hera në ditë kontrollohen pikërisht për këtë arsye. Nëse daktoresha e ngriti si shqetësim, e cila është e përgjegjshme edhe në aspektin intelektual, por edhe në profesionin që bart thotë 30 për qind të nxënësve janë përdorues të këtyre substancave, atëherë kjo krijon një shqetësim që duhet çuar peshë të gjitha institucionet e këtij vendi. Komandanti i Policisë është këtu, besoj që ka marrë mesazhin se kjo tamam nuk është në domenin as e ekzekutivit, as AK, për t’u marrë konkretisht me këtë çështje, atëherë komandanti le ta procedojë këtë çështje në linjat dhe vijat ligjore dhe le të merren edhe ato masa se po që se ekziston ky fakt nuk duhet të na zënë gjumi asnjërin prej nesh deri sa të verifikohet. Nëse ekziston diçka e tillë, atëherë vaj halli për këtë shoqëri për të ardhmen. Kështu që të mos caktojmë afate,

limite se kur duhet të dalin organet e rendit me një raport, mirëpo në momentin këta e marrin sinjalin, është denoncim publik që bëhet për këtë kategori dhe për këtë çështje, t'ju japim hapësirë këtyre në mënyrë që këta le të veprojnë dhe të gjejnë edhe formën vërtetë se si duhet për t'i trajtuar këto raste. Organet e hetuesisë e kanë këtë çështje dhe le të vazhdojnë”, theksoi kryetari Bashota.

Vlora Tafili, tha se një fjalë e urtë popullore thotë, “ku ka tym, ka edhe zjarr”. “Edhe në këtë fjalën time të rastit desha të lidhem edhe për t'ia cekur nënkryetarit se veç po shihet shqetësimi edhe jashtë asambleje, edhe të të rinjve, edhe kjo hyn në kuadër të kompetencave të këshillit tuaj, se ju jeni drejtor për Bashkësi dhe Siguri në Komunë. Edhe e patëm këtu fushatën vetëdijesuese për parandalimin e dukurive negative. Kjo ishte edhe arsyeja pse ju bëra pyetje juve, se duhet formuar një grup për ta funksionalizuar këtë plan të veprimit”, tha anëtarja Tafili.

Haxhi Ibishi, sqaroi se grupi për funksionalizim të Panit të Veprimit ekziston.

Vlora Tafili, tha se ai nuk e ceku që ekziston ky grup.

Fadil Gashi, tha se unë tash e kam kundërshtimin me kryetarin: Jo organet, Kryetar, as kjo tendencë e juaja nuk është e mirë, shqetësimi është në AK, dalloj këto. “Asamblistja nga radhët tona kërkoi një përgjigje prej organeve tona të ekzekutivit. Është e juaja a e merrni prej Komandantit, a e merrni prej organeve të prokurorisë, a e merrni prej organeve të shkollës, na bini informacionin, a ka të vërteta apo nuk ka të vërteta. Ne jemi duke kërkuar prej jush, ju tash po kthehi dhe po kërkoni prej nesh. Ne nuk kemi me politikë asgjë, ju e keni, ne po kërkojmë prej ekzekutivi, kjo është e drejtë jona me pyetur, dhe nëse s'ka të parët do të jemi që kemi për të duartrokitur. 30 përqindëshin po e thonë të gjitha mediet, po e thonë të gjitha forumet, të gjitha institucionet, sepse është shqetësim i gjithë Kosovës nuk është as i kësaj asambleje, as i një individi. Unë kam dëshirë që zero të dal për Klinë, se unë më së paku i kam dy fëmijë aty, secili prej nesh ka dikë aty, nuk kam dëshirë fare, por mos e merrni kështu. Le ta merr Komandanti, nëse ka rast që e kanë marrë le të na informohet, është një, dy ose s'është asnjë. Nuk është hera e parë që debatojmë këtë çështje, madje ju a e dini që në seancën e kaluar kemi miratuar një planë që ka prurë Drejtoria e Arsimit, e kemi miratuar dhe në një pjesë të këtij plani, të asaj strategjie, potencohen edhe lokalet që janë afër shkollave. Pahiri i kanë qitur ato. Domethënë ka diçka edhe janë vu rastësisht ato lokale që frekuentohen afër shkollave. Edhe e kemi pasur disa herë biseda a ka mundësi për t'u mbyllur krejt ato lokale. A s'këtë nuk e kemi bërë pahiri për t'i mbyllur çajet as lëngjet, por për një arsye është kërkuar a ka mundësi për t'u mbyllur ato lokale. Edhe një kërkesë e veçantë ka qenë edhe a ka mundësi edhe për t'u bastisur më shpesh ato lokale, edhe kjo ka qenë. Prandaj, mos ta shterim këtë, për seancën e radhës na bini ju, ju vendosni kush e bien këtë informatë” tha anëtari Gashi.

Sokol Bashota, tha se unë nuk kërkova asgjë prej jush, mirëpo ju e dini sa janë kompetencat e ekzekutivit për t'u marrë me këso çështjesh, duhet pasur mundësitë, por të jemi një të vetëdijshëm: “Unë e dëgjova mire çka tha doktoresha. Ajo konstatoi, nuk ka kërkojmë përgjigje a ka, por tha janë rreth 30 për qind përdorues, e ku ka konstatim,

atëherë është denoncim publik. Ne prapë nuk rrimë. Mirëpo, kur të thuhet si konstatim, atëherë është shqetësim. Por kur thuhet gjithsesi janë 30 për qind, kjo është tepër shqetësuese”, ka shtuar kryetari Bashota.

Pjetër Coli, tha se unë e kërkova fjalën atëherë kur patëm temën e pragjeve në trafik. “Por, tash thënë të vërtetën është pa domethënie, në krahasim me temën që e trajtuam në fund, e cila është, jo shqetësuese, por është njëmend alarmante. Dhe secili, i cili kontribuon për sanimin e këtij problemi, unë personalisht i falënderohem se është në pyetje ardhmëria e jonë. Për pengesa në rrugë, desha gjithë atyre që kanë mendimin tjetër t’ju them se policia, radarët e kanë për qëllim disiplinimin e vozitësve. Por, nëse ajo nuk ka funksionuar, edhe është e vërtetë që nuk ka funksionuar, është dashur për ta marrë një masë shtesë, e këto janë këto pengesa që po i vendosim në nëpër rrugë, se ndërjegjja e vozitësve tanë, pra, është në atë nivel ku ne nuk i respektojmë shenjat e komunikacionit ose policinë. Edhe nëse është vendosur pragu, është vendosur me synim që të zvogëlohen rastet, domethënë aksidentet. Edhe nëse drejtori kompetent thotë në AK që rastet janë zvogëluar për 50 për qind, ato e kanë dhënë efektin e vet. Mua më duket se më me rëndësi është të evitohet një aksident, qoftë edhe i vogël, se sa t’i prishet vetura dikujt kur e kalon atë farë pragu, shkon më ngadalë. Unë jam shumë i thhtar i madh që ato pragje për të ekzistuar, tha anëtari Coli.

Ramiz Rrusta, drejtor i Financave, tha se pyetjen Arbeni më ka bërë para një muaj ose dy, rreth mundësisë së zbritjes së taksës për bizneset kah i përshkon rruga ku është duke u ndërtuar sheshi. “Më herët është marrë vendim për shkallën e taksës së biznesit që tarifin, të gjitha të tjerat, kjo është një punë që janë disa procedura tjera, shkalla edhe për këtë vit është votuar e njëjtë do të jetë, por në këtë rrugë janë disa biznese, unë e di që ndoshta kanë më pak të hyra, por llogaritni që janë edhe bankat, pikërisht që afarojnë dhe ne si komunë që arkëtojmë të hyra prej këtyre bizneseve. Drejtorit të Inspektoratit dua t’i përgjigjem të një pyetje që dha më parë kur tha se gjobat në trafik janë zvogëluar si të hyra, por unë po them që komuna e Klinës, nuk po dua këtu para komandantit të policisë, me dhënë një raport, por ne si DF po na vjen raporti vjetor i gjobave nga trafiku dhe gjobat tjera, Komuna e Klinës është diku në vendin e pestë apo të gjashtë prej të gjitha komunave në nivel të RK, ku inkasojnë të hyra nga gjobat në trafik. Raporti që ka ardhur tash, unë do t’ju prezantoj në muajin tjetër, keni për t’u bindur që këta gati janë rekord, prandaj sa i përket gjobave jemi në nivel”, sqaroi drejtori Rrusta.

Pjetër Coli, tha se apeloj te drejtori, meqenëse kjo rruga djathtas prej meje tash, është arteria kryesore e trafikut rrugor për drejtim të veriut në Klinë që shenja STOP në kryqëzim me rrugën që vjen prej fushës sportit aty, të hiqet se është e pakuptimtë me pasur një shenjë STOP arteria kryesore dhe me pasur përparësi banorët aty që vjen një veturë në 10 minuta”, theksoi anëtari Coli.

Pika e pestë: Njoftim i pasqyrave financiare të audituara në kompaninë e mbeturinave regjionale “Ambienti”

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. “Unë shfrytëzoj rastin në emër tuajin të përshëndes drejtorin gjeneral që është këtu prezent me neve, Nexhat Avdullahun, i cili

me prezencën e tij tregon për seriozitetin e çështjes së ngritur dhe që do të diskutohet në këtë AK. Unë kisha bartur fjalën te drejtori i Ambientit, le të na jep disa sqarime në pika të shkurtra rreth këtij Raporti të Auditorit”, tha kryesuesi Ibishi.

Fadil Gashi, tha se ne e kundërshtuam, ne e votuam, për ne nuk është interesant se çfarë flet, por për proces le të jetë: “Ju e miratuat pasqyrën financiare ky material, përkatësisht Informatë për pasqyrat financiare. Tash neve na ka ardhur dy faqe Raport i Auditorëve të Pavarur, materiali kështu është. Edhe veç dy faqe i ka raport i auditorit, pastaj janë disa tabela që s’janë as të nënshkruara, as të protokolluara, as kurrëgjë! Edhe tash, nëse është material legal ky, mirëpo unë mendoj që është ilegal, edhe s’është zyrtar. Edhe tash saktësoni për proces se jo për ne, se ne edhe ashtu kundër kemi votuar”, tha anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se rreth të gjeturave, këtu e kam të shkruara, Njoftim rreth Raportit të Auditimit të Pavarur për kompaninë “Ambienti” 2014-2015, kështu kemi votuar ne.

Grupi i anëtarëve të LDK-së e braktisen seancën.

Nexhat Avdullahu, kryeshef i KRM “Ambienti” në Pejë në mënyrë kronologjike referoi rreth Raportit Financiar të Auditorëve të Pavarur për Menaxhmentin e KRM “Ambienti” në Pejë 2014-2015. “Ky është dokument më se ligjor, në ballinë shkruan: Firmë ligjore e auditimit”, nuk është dokument i falsifikuar, janë edhe organet kompetente që mund t’i ndjekin këto gjera. E dyta, nuk kërkohet kurrfarë miratimi, sepse bëhet fjalë për tri komuna, asnjë komunë nuk me miratuar ose mos me e miratuar, por kërkohet vetëm me ju njoftuar KK i secilës komunë për procedurat që i kanë proceduar. Domethënë, një auditim që është kërkesë ligjore për të gjitha kompanitë. Sa i përket tjetrës, nëse, jo nëse ju si KK duhet ta keni Raportin e punës, Raportin vjetor të punës së Njësisë së Klinës, ku prezantohen Raporti operativ dhe Raporti financiar. Unë besoj që edhe me ndihmën e drejtorit Gjokë Lleshi dhe të menaxherit të njësisë, Dardanit, ne do ta përpilojmë bashkë atë raport, edhe do t’ju silllet juve në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Domethënë, nuk është fjala këtu për miratim, se ju nëse kërkohet miratim mundet Klina me miratuar, Peja të mos e miratojë dhe nuk bëhet asgjë. Nuk mundet një komunë për tjetrën me prurë vendim me miratuar ose mos me e miratuar. Kërkohet shumë decitivisht: me u njoftuar kuvendet komunale të tri komunave për procedurën që është kryer një auditim ligjor me të gjitha procedurat tenderuese, e jo falsifikuese, siç e ceku dikush, sepse për këto punë dikush jep përgjegjësi. Kjo punë kryhet me para, kanë konkurruar disa kompani, e kemi përzgjedhur atë më të lirën, aq sa kemi pasur para. Domethënë kjo është tërë ajo çka është kërkuar sot prej juve. Në të njëjtën kohë është duke u mbajtur seanca e KK në Pejë, ata nuk me kanë thirrur t’u jap sqarime, sepse e kanë të qartë për çka është fjala, është edhe Istogu dhe krejt që kërkohet, që këto pasqyra janë me i futur në ueb faqen e Komunës së Klinës, edhe për t’u lëshuar një njoftim për GIZ-in që KK është i njoftuar për auditivin e pavarur për vitin 2014-2015”, ka sqaruar z. Avdullahu.

Haxhi Ibishi, tha se ne jemi shumë të vetëdijshëm për rolin që kemi, por, thjesht, këto detyrime që kemi me konkurruar me një projekt të përbashkët, duhet me qenë të përgjegjshëm prej secili prej neve, sepse në një farë forme informatën që është zyrtare prej juve ta kemi edhe ne”, tha kryesuesi, Dr. Ibishi.

Ndue Shabanaj, tha se ne e miratuam këtë dhe e vendosëm si pikë të veçantë të rendit të ditës dhe patëm mirëkuptim. “Unë mendoj që pavarësisht kush e ka përgjegjësinë aty ku ka informatë, ku ka njoftim, ku ka raport, ka mundësi të diskutimit, ka mundësi të papajtushmërisë, qoftë edhe të refuzimit. Po edhe nëse kompania “Ambienti”, që është regjionale nuk e ka këtë obligim ndaj AK, e ka Njësia në Klinë dhe është mirë mos me i ikur përgjegjësisë që ka kushdo qoftë në këtë drejtim. Çka më bëri përshtypje mua që në një formë nuk më tingëllojë mirë, të mos them ma vrau veshin, por nuk më tingëlloi mirë, kjo se u tha këtu nga zotëria i respektuar se Klina në të njëjtën kohë me Pejën e mbajnë seancën e AK, atje nuk ka pasur nevojë të shkohet se e kanë të qartë, dhe se këtu paska nevojë për te ardhur se nuk jemi të qartë. Nuk qëndron kjo absolutisht, krejt kjo çështje është se lidhur me atë që në mungesë të materialit nuk mund ta kemi të qartë, se përmendsh nuk mund ta kuptojmë atë, edhe tash sa i përket materialit nuk kemi mundësi për ta pasur të qartë, se nuk e kemi shqyrtuar atë material, nuk e kemi analizuar, e futem në pikë të veçantë të rendit të ditës, jemi duke dashur për të proceduar edhe për t’u kryer kjo punë, po jo edhe pjesa tjetër se nuk e paskemi të qartë ne. Nuk jam duke e dashur pa kurrfarë keqkuptimi, por atë që e themi duhet realisht për ta ditur”, theksoi prof. Shabanaj.

Tunë Dedaj, tha se unë vetëm desha ta falënderoj drejtorin dhe ne si opozitë e votuam për hir të disa projekteve që këta kanë përfitime prej dikujt me i marrë disa mjete. Mirëpo po shfrytëzoj rastin në emër të qytetarëve për ta bërë një kërkesë te drejtori gjeneral. Jam i kënaqur me mbledhjen e mbeturinave përpos kur ishte bora e madhe nuk kanë mundur me ardhur dy javë nëpër fshatra, por është mirë që çdo fshat t’i ketë kontejnerët për grumbullim e mbeturinave”, tha anëtari Dedaj.

Pika e gjashtë: Informatë rreth gjendjes së rrugëve në Komunën e Klinës

Kryesuesi foli rreth çështjes në shqyrtim. Fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente, z. Gjokë Lleshaj.

Gjokë Lleshaj, drejtor i DSHPE, foli rreth gjendjes së rrugëve në Komunën e Klinës. “ndoshta të diskutohet si pikë e rendit të ditës është herët sepse jemi në mesin e dimrit dhe mund që prapë të bie borë dhe prapë ndoshta duhet të bisedohet, por sa herë që të jetë nevoja do të diskutojmë. Jeni edhe ju në dijeni, më datën 5 janar 2017 kanë filluar të reshurat e borës dhe DSHP iu ka qasur seriozisht kësaj çështjeje dhe ka marrë çdo masë duke e ditur se kemi pasur edhe kompaninë dhe kemi punuar maksimalisht në pastrimin, respektivisht në zhblokimin e të gjitha rrugëve të fshatrave dhe të qytetit të Komunës së Klinës. Fillimisht i kemi pasur disa vështirësi me kompaninë për shkak të disa defekteve por nuk kanë zgjatur gjatë, dhe shumë shpejt janë eliminuar edhe kompania ka punuar së bashke me inspektorët që kanë qenë në mbikëqyrje, por asnjëherë pa u shkëputur unë edhe me orë të tëra ose 24 orë. Kështu që gjendja e rrugëve vazhdimisht ka qenë e zhblokuar dhe ka qenë në nivel ndoshta ndër komunat më të mira në Kosovë. Gjatë gjithë kohës rrugët kanë qenë të zhblokuar në përjashtim të disa fshatrave me disa orë, jo me ditë. Vështirësitë më të mëdha kanë qenë në Cerovik, Çabiq, Dobërdol, Siqevë, Zabergjë dhe Leskoci, një pjesë e Leskocit, në drejtim të kodra te Caritasi. Kështu që, gjatë krejt kohës gjendja në rrugët e Klinës ka qenë e mirë dhe e kalueshme”, ka konstatuar drejtori Lleshaj.

Vlora Tafili, tha se është dashur për të qenë më konkret dhe në mënyrë më të detajuar. “Nënkryetari tha se po flisni me fjalë të kafeve dhe të rrugëve, por unë vetë kam qenë e pranishme në 20 fshatra të Komunës së Klinës dhe në disa prej tyre nuk ke qenë fare. Mund t’ju potencoj me emra, e ke Poterqin, Dugajevën, Drenocin, Deiqin, Kërniceën tash para një jave ke qenë dhe e ke qitë kripën, kur është hequr në tërësi, jo veprim i mirë, Jagodën, Jashanicën e Lartë, Përçevën, Ryudicën, Rigjevën, nuk ke qenë, edhe disa fshatra të tjerë. Qysh i thoni kësaj pune?- ka shtuar anëtarja Tafili.

Gjokë Lleshaj, tha se më vjen keq se edhe pyetjen që është futur në rend të ditës nuk e ke pasë të qartë. “A lype informatë, apo lype raport? Lype një informatë për gjendjen e rrugëve. Për të gjitha këto, u desh të keni durim, unë nuk i kam të gjitha shënimet tani për tani me t’i prurë, me ditë e me datë. Nëse edhe kësaj radhe mund të thoni se gjendja e rrugëve është e keqe, ju them sinqerisht që nuk bëhet politika në Kuvend. Politika nuk bëhet as nuk mund të përfitoni në këtë mënyrë kur nuk janë të vërteta. Politika bëhet kështu si është e drejtë, politikë mund të dilni në rrugë. Mos shfrytëzoni për të bërë politikë për të përfutur këtu, sepse gjendja e rrugëve në Komunën e Klinës është me kompetencë e them që ka qenë më e mira në krejt Kosovë. Nëse edhe kësaj radhe thoni keq keni problem me vetveten dhe nuk mund të përfitoni, unë nuk mund t’ju ndalojë çfarë mund të thoni, por rrogat kanë qenë të zhbllokuara krejt kohën. Asnjë rrugë nuk ka qenë e bllokuar. Intervenimet janë bërë me kohë dhe fillimisht janë bërë në zonat malore”, ka shtuar drejtori Lleshaj.

Tunë Dedaj, tha se unë mendoj që këtu nuk vijmë për të bërë politikë, këtu vijmë për shqetësimet e qytetarëve që janë. “Unë kam thënë edhe në Radio Alba i kam thënë drejtorit të SHP, kontrata që ka qenë ka qenë e bërë me kompaninë për mirëmbajtjen e rrugëve dimërore ka qenë kontratë e keqe, që edhe sot e konstatoj dhe e vlerësoj së është e keqe, se ka lënë shumë fshatra pa u përfshirë dhe pa hyrë në atë prioritet për pastrimin e rrugëve. Është dashur për të qenë të gjitha fshatrat, po t’i tregoj fshatrat që s’kanë qenë, drejtor, ka qenë, si Poterqi, Drenoci, Dugajeva, Dresniku, Dollci, Krusheva e Vogël, Radulloci, Pataqani, Pogragja (brenda në fshat), edhe ai fshat është kodrinor, edhe Krusheva është vend kodrinor, keni shkuar pas një kohe shumë të gjatë, e keni hedhur kripën, në Deiq keni ardhur me vonesë, do të thotë kontrata ka qenë e bërë keq se nuk ka përfshirë të gjitha fshatrat. Edhe një herë po e them: ju e keni fituar të drejtën për të qeverisur me paratë e taksapaguesve për këto katër vite. Unë ku është mirë ju përkrahi, ku është keq do t’ju them se është keq. Do të thotë se angazhohem në maksimum që qytetarët të përfitojnë prej kësaj. Ne angazhohemi që qytetarëve t’ju lehtësojmë edhe kur është dimër, edhe kur janë vërshimet, ju dalim në ndihmë”, tha anëtarja Dedaj.

Halil Desku, tha se unë së pari shpresoj që të mos ketë edhe ndonjë tjetër që më thotë këtu, po flet në emër të drejtorit të Arsimit, a të shërbimeve publike, po ju del zot këtyre, unë, thjeshtë, edhe më parë kam folur me kompetencë profesionale, edhe qytetare, do të thotë jam duke folur me kompetencë qytetare, jo profesionale. “Unë jetoj në zonën veriore dhe të gjithë e dinë këtu se zona veriore, përveç që është veriore, është edhe më larta në lartësi mbidetare, ku reshjet e para na takojnë ne. Unë kam lëvizur në gjithë zonën jo për këtë qëllim, në krejt zonën kam lëvizur në zonën time, duke përfshirë fshatin dhe kam parë një punë si asnjëherë më përpara. Rigjevë, Gllarevë, Cerovik, Siqevë Jashanicë, Ujëmirë, jam ardhur në Klinë në punë dhe kam parë një punë si asnjëherë më

përpara. Në flluskat e para të borës këta kanë qenë me makina aty. Kurrë nuk e besoj që këta diku kanë pastruar e diku nuk kanë pastruar se lirshëm kanë lëvizur qytetarët në krejt territorin e Komunës së Klinës. Unë mendoj kështu. Nga përvoja ime, thjeshtë, pa kompetencë të këtyre, për t'ju treguar edhe këtyre të tjerëve se po flas me kompetencë qytetare. Uroj që gjatë të qëndrosh në këtë detyrë!”- tha prof. Desku.

Vlora Tafili, tha se nuk po dua të lidhem më këto që i tha profesori im, mirëpo në Poterq nuk keni qenë që 16 vjet, mos i bini për hava se nuk bën. “Nëse dëshiron të flasësh me kompetencë qytetare të jesh pak më konkret. Nuk prish punë Gjokë, e mora me nxitim, kur të kryhet sezoni dimëror, unë dhe ti jemi në interpelancë. Edhe nëse del ashtu qysh po thua ti, edhe Halil Desku, unë do të jap dorëheqje prej pozitës së asamblistes”, tha anëtarja Tafili.

Sokol Bashota, foli rreth çështjes në shqyrtim. “U lyp informacion, edhe në pamundësi për të dhënë më shumë, edhe pse Gjoka në këtë rast është kompetent, jo për detyrën që ka, por për shkak se, nuk e di sa keni informacionin ju, e di që deri në 12 të natës ka qëndruar më kompaninë, edhe policia e dinë, e dinë edhe inspektorët, ka qëndruar së bashku në terren. Nuk hiqet si me shkop magjik bora në tërë territorin e Komunës së Klinës, në 54 fshatra sa janë ato brenda një minute, apo brenda një dite. Por, prioritet ju kanë dhënë gjithmonë vendeve që janë pak më me probleme në komunikacion, të jeni shumë të sigurt rrugët më mirë nuk kanë qenë kurrë, edhe më mirë jemi se sa të gjitha komunat e Kosovës. Patjetër se keni për ta pasur raportin, kërkojeni raportin, keni të drejtë për të kërkuar raportin, keni të drejtë edhe interpelancën dhe nuk do t'ju shmang askush, të jeni të sigurt shumë për këtë punë, se këta janë për t'ju dhënë sqarime edhe juve”, tha kryetari Bashota.

Ramush Agushi, tha se shkurt desha të ndërlihem me temën. “Unë tash po më vjen keq që drejtori është i Pejës, jeton në Pejë, por në zonën ku jetoj sot të vijë të shoh është shumë vështirë të hyhet dhe të dilet, por ne e kuptojmë për shkak të temperaturave dhe të ngricave që i kemi afrohem, sepse më kot vendoset kripë në temperaturat tepër të larta dhe nuk është e mundshme në këso temperatura të hiqen akullnajat që janë krijuar për shkak të temperaturave kaq të ulëta edhe borës që kemi. Unë sot te banesa ime duhet lënë veturën diku 20 metra, qysh mund të afrohem, përkatësisht ta çoj veturën time te parkingu ku e paguaj . Edhe duhet për t'i kuptuar temperaturat që kanë qenë aq të larta sa që kot kanë hedhur kripë nëpër rrugë, se temperaturat nën minus 5 sa di unë kripa nuk reagon. Kështu që jemi falënderues në atë që jeni duke dhënë një kontribut edhe nuk është aq tragjike sa që e kemi në komunat tjera”, ka shtuar anëtarja Agushi.

Haxhi Ibishi, tha se unë jo për servivizlizëm absolutisht, por për një korrektësi dua ta falënderoj Kryetarin, Ekzekutivin për gatishmërinë gjithmonë për interpelancat e mundshme që iu kanë ofruar kësaj asambleje. “Unë kam qenë edhe shef opozite kur nuk e kemi pasur këtë mundësi, unë jam i bindur që edhe propozimit të opozitës sot, e çmoj me konstruktivitet shumë qasjen e tyre, pika e rendit të ditës që erdh prej opozitës, kjo flet për një kulturë demokratike, u shtjellua debati, edhe thashë gatishmëria e Kryetarit, që të gjithë drejtorët edhe temat që janë në interes të qytetarëve, mund të diskutohen në secilën kohë, vetëm të përfillen ligjërisht afatet tona”, ka shtuar Kryesuesi.

Sokol Bashota, tha se po dua t'ju bëj thirrje edhe një herë për t'ju kujtuar ju një vendim që keni marrë këtu në AK që këshilltarët për t'u nënshkruar në fund të seancës të asamblesë e jo në fillim të asamblesë. “Dhe ka të drejtë çdo qytetar, çdo asamblist, çdo grup parlamentar për ta lëshuar seancën për qëndrimin e vet politik, por në fund të seancës për të ardhur dhe nënshkruar. Falënderoi anëtarët e KK për mbështetjen dhe kontributin e dhënë”, ka pohuar kryetari Bashota.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI

